



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 1420 / Prot.  
4

Tiranë, më 01/07/2020

UDHËZIM

Nr. 3, datë 01.07.2020

PËR

**“PEZULLIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, 39 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të 5, 28, 29 pika 2 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përherëshme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të Urdhrit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 175, datë 30.06.2020 “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, si dhe me qëllim evitimin e të gjitha vendimeve që mund të dëmtojnë integritetin e zgjedhjeve në UMT,

UDHËZOJ:

1. Të pezullohet veprimtaria e Komisionit të Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Të pezullohet veprimtaria e Komisioneve të Përherëshme për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në të 3 (tri) njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky udhëzim i shtrin efektet e tij deri në përfundimin e procesit të votimit të zgjedhjeve universitare të vitit 2020 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Kryetari i Komisionit të Përherëshëm të Promovimit Akademik në UMT, Kryetaret e Komisioneve të Përherëshme për Dhënien e

Gradës Shkencore “Doktor” në të 3 (tri) njësitë kryesore në UMT-së dhe dekanët e fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

**REKTORI**  
**ARBEN GJATA**

